



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr 19 Datë 27/07/2016

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË PROMOVIMIT, “BRANDIT” TURISTIK
TË QARKUT VLORË

Këshilli i Qarkut Vlorë , në mbledhjen e datës ___/07/2016 , në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”, neni Neni 77 pika l), bazuar në “Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut Vlorë 2011-2020”, si dhe në mbështetje vizionit të Institucionit për promovimin e identitetit të qarkut Vlorë në tregun vendas dhe ndërkombëtar si një destinacion i rëndësishëm turistik dhe duke synuar rritjen e numrit të turistëve vendas e sidomos të huaj. Duke marrë shkas shembujt e rajoneve të vendeve fqinje për krijimin e një strategjie promovimi dhe “Brandimi” që përfaqëson imazhin turistik rajonal, si dhe duke u nisur nga nevoja për krijimin e një imazhi unik dhe origjinal i cili reflekton më së miri energjinë dhe vitalitetin e popullit tonë, potencialin e madh për zhvillim, traditën e mikpritjes, kulturën e pasur dhe trashëgiminë e jashtëzakonshme historike, vendet dhe peizazhet e mrekullueshme:

V E N D O S I

- 1) Miratimin e “BRANDIT” turistik të Qarkut Vlorë
 - a. Logo do të përdoret gjithmonë në versionin e miratuar (si në dokumentin bashkangjitur) duke respektuar të gjitha standartet e përdorimit të përshkruara në manualin e përdorimit (Brand Guide – Standartet e Identitetit)
 - b. Emri identifikues i territorit që përfaqëson ky brand/logo do të jetë në gjuhën angleze – **SOUTH COASTAL REGION** dhe nënkupton gjithë territorin e mbuluar nga Qarku Vlorë.
 - c. Brandi i ri t’i shpërndahet gjithë njësisve vendore të qarkut sëbashku me manualin e përdorimit (Brand Guide – Standartet e Identitetit) të cilat mund ta përdorin këtë “brand” me qëllim promovimin
 - d. Logo e re (**South**) do të integrohet në të gjitha shkresat e institucionit me përmbajtje dhe tematikë turizmin.
 - e. Logo do të përdoret gjithashtu në të gjitha tabelat informuese, pjesë e projekteve që implementon Këshilli i Qarkut, sëbashku me logon zyrtare të institucionit.